



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK
NJËSIA BAZË (DEPARTAMENTI) I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT
JAVA 20
11 maj – 17 maj 2026

Për këtë javë, kanë raportuar 36 Njësi Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) ose 100% (=36/36) e tyre.

Tabela 1. Plotësimi i formularit ALERT sipas çdo NJVKSH-je

Perqindja e plotesueshmerise				
Rajoni	Qarku	Njvksh	Nr. Qendrave	%
TIRANË	Tiranë	Tiranë	35 / 35	100%
		Kavajë	9 / 10	90%
	Durrës	Durrës	20 / 20	100%
		Krujë	6 / 6	100%
	Dibër	Dibër	16 / 16	100%
		Mat	13 / 13	100%
		Bulqizë	9 / 9	100%

ELBASAN	Elbasan	Elbasan	28 / 28	100%
		Librazhd	11 / 12	92%
		Gramsh	8 / 8	100%
		Peqin	6 / 7	86%
	Korcë	Korçë	18 / 18	100%
		Pogradec	9 / 9	100%
		Devoll	6 / 6	100%
		Kolonjë	4 / 4	100%
	Berat	Berat	15 / 15	100%
		Kuçovë	4 / 4	100%
		Skrapar	7 / 7	100%
SHKODËR	Shkodër	Shkodër	19 / 19	100%
		M. Madhe	6 / 6	100%
		Pukë	10 / 11	91%
	Kukës	Kukës	13 / 14	93%
		Has	5 / 5	100%
		Tropojë	9 / 9	100%
	Lezhë	Lezhë	10 / 10	100%
		Kurbini	5 / 5	100%
		Mirditë	5 / 6	83%
VLORE	Vlorë	Vlorë	21 / 21	100%
		Sarandë	10 / 10	100%
		Delvinë	5 / 5	100%
	Fier	Fier	20 / 20	100%
		Lushnjë	18 / 18	100%
		Mallakastër	9 / 9	100%
	Gjirokastër	Gjirokastër	21 / 21	100%
		Përmet	8 / 8	100%
		Tepelenë	7 / 7	100%
		TOTAL	425 / 431	99%

Tabela 2. Numri Total i Rasteve të Sindromave të Survejancës “Alert” në Javën 20

	JAVA 20
Diarre pa gjak	1412
Diarre me gjak	0
Inf. Resp. të sipërme	7396
Inf. Resp. të poshtme	2888
Rash me temperaturë	43
Verdhëza	0
Ethe e zgjatur e pashpjeguar (> 3 javë)	0
Anomali kongenitale	0
Konjuktivit akut te neonatët	0
Numri i Njësive Raportuese	425
% e Njësive Raportuese	99% (425/431)

Rash me temperaturë

Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog, rastet e mëposhtme nuk janë të dyshuar për fruth, rubeolë apo linë e majmunit, por për variçelë:



Tiranë – 22 raste

Fier– 10 raste

Vlore – 9 raste


Diber – 1 rast

Puke – 1 rast


Grafiku 1. Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme sipas javëve**Grafiku 2. Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme sipas grup-moshave**

Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme paraqet ulje në javën 20 të vitit 2026 krahasuar me javën paraardhëse, java 19.

Grafiku 3. Trendi në kohë i Diarreve pa gjak sipas javëve




Grafiku 4. Shpërndarja e Diarreve pa gjak sipas grup-moshave




Prirja në kohë e “Diarreve pa gjak” paraqet rritje në javën 20 të vitit 2026 krahasuar me javën paraardhëse, java 19.

Grafiku 5. Krahasimi i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” sipas sezoneve (javët 40 – 20) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000




Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme paraqet ulje në javën 20 krahasuar me javën paraardhëse, duke mbetur ne intensitetet te ulet sezonal.

Grafiku 6. Prirja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” në javët 05 – 20 të sezonit 2024-2025 dhe sezonit 2025-2026. Numri i rasteve.




Në javën 20 të vitit 2026 vërehet një ulje e numrit të Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme.

Grafiku 7. Frekuenca e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” sipas grupmoshës. Incidenca (raste/10.000)




Grafiku 8. Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” sipas NJVKSH-ve në javën 19/2026 dhe 20/ 2026. Incidenca (raste/10.000).




Vërehet një rritje e lehtë infeksioneve respiratore në disa NJVKSH por aktiviteti i gripit ne total këtë javë paraqitet në rënie.

Grafiku 9. Prirja e “Diarreve pa Gjak” në javët 05-20 të sezonit 2024-2025 dhe sezonit 2025-2026. Numri i rasteve.



Në javën 19 vërehet prirje në rritje e numrit të rasteve “Diarre pa gjak”, këtë vit vërehet një numër më i madh i këtyre infeksioneve, krahasuar me një vit më parë.

Grafiku 10. Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas NJVKSH-ve në javën 19-20/2026
Incidenca (raste/10.000).



Vërehet një rritje e rasteve me diarre, veçanërisht në NJVKSH Mirdite, Vlore dhe Sarande, Gjirokastrë ku situata po monitorohet në mënyrë të vazhdueshme.

Ngjarje ndërkombëtare

Epidemia e sëmundjes Ebola nga virusi Bundibugyo në Republikën Demokratike të Kongos dhe Ugandë – Shpallja e PHEIC

Më 17 maj 2026, OBSH shpalli epideminë e sëmundjes Ebola të shkaktuar nga virusi Bundibugyo në Republikën Demokratike të Kongos (RDK) dhe Ugandë si një Emergjencë të Shëndetit Publik me Rëndësi Ndërkombëtare (PHEIC). Megjithatë, ajo nuk plotëson kriteret për një emergjencë pandemike.

Deri më 16 maj 2026, **në provincën Ituri të RDK-së** janë raportuar:

- 8 raste të konfirmuara laboratorikisht,
- 246 raste të dyshuara,
- 80 vdekje të dyshuara.

Në **Kampala, Ugandë**, janë raportuar dy raste të konfirmuara (njëri fatal) tek persona që kishin udhëtuar nga RDK-ja, duke konfirmuar përhapjen ndërkombëtare të sëmundjes.

Janë raportuar gjithashtu grupe vdekjesh në komunitet dhe të paktën katër vdekje të punonjësve shëndetësorë, duke ngritur shqetësime për transmetim brenda institucioneve shëndetësore dhe mangësi në masat e parandalimit dhe kontrollit të infeksioneve.

OBSH vlerëson se numri real i rasteve mund të jetë shumë më i lartë për shkak të pasigurisë epidemiologjike, lëvizshmërisë së lartë të popullsisë, krizës humanitare dhe rrjetit të madh të strukturave joformale shëndetësore.

Aktualisht nuk ka vaksina ose trajtime specifike të miratuara për virusin Bundibugyo.

OBSH rekomandon forcimin urgjent tëurvejancës, gjurmimit të kontakteve, kontrollit të infeksioneve, laboratorëve diagnostikues, komunikimit të riskut dhe koordinimit ndërkombëtar.

OBSH nuk rekomandon mbyllje kufijsh apo kufizime të udhëtimit dhe tregtisë, pasi masa të tilla nuk bazohen në prova shkencore dhe mund të dëmtojnë përgjigjen ndaj shpërthimit.

Pas rasteve të raportuara në Ugandë dhe Republikën Demokratike të Kongos (RDK), OBSH deklaroi, sipas Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit (IHR), se kjo ngjarje përbën një Emergjencë të Shëndetit Publik me Shqetësim Ndërkombëtar (PHEIC).

Duhet të kemi parasysh se:

- Kjo deklaratë lidhet vetëm me këtë ngjarje dhe nuk përbën deklaram pandemie.
- PHEIC tregon se ngjarja ka rëndësi ndërkombëtare dhe kërkon koordinim global.
- OBSH mund të japë rekomandime dhe udhëzime për shtetet anëtare, veçanërisht për vendet e prekura dhe ato kufitare.
- Deklarimi ndihmon në mobilizimin e burimeve financiare dhe mbështetjes ndërkombëtare, sidomos për vendet me kapacitete të kufizuara.
- Nëpërmjet PHEIC aktivizohet zbatimi i Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit për një përgjigje të shpejtë dhe efektive ndaj ngjarjes.

Gripi i shpendëve A(H5N6) – Monitorimi i rasteve tek njerëzit

Një rast i infeksionit tek njerëzit me virusin e gripit të shpendëve A(H5N6) u raportua nga OBSH në Përditësimin Javor të Gripit Avian më 8 maj 2026.

Rasti ishte një grua rreth të pesëdhjetave nga Bashkia Chongqing, Kinë.

Pacientja raportoi ekspozim të drejtpërdrejtë ndaj shpendëve.

Që nga viti 2014, në Kinë janë raportuar 93 raste të konfirmuara laboratorikisht të infeksionit A(H5N6) tek njerëzit.

Deri më sot, nuk janë dokumentuar raste të transmetimit nga njeriu tek njeriu.

Rreziku i transmetimit zoonotik të gripit tek popullata e përgjithshme në vendet e BE/ZEE mbetet shumë i ulët.

Raste tek njerëzit të infeksionit me virusin e gripit të derrit A(H1N2) variant – Shumë vende – 2024

Një infeksion human me virusin variant të gripit A(H1N2)v me origjinë nga derrat është raportuar në shtetin Nebraska, SHBA.

Pacienti ishte nën 18 vjeç, nuk u shtrua në spital dhe tashmë është shëruar.

Hetimet nuk gjetën kontakt të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me derra.

Një kontakt i afërt u sëmur në të njëjtën kohë, por nuk u identifikuan raste të tjera të lidhura me këtë infeksion A(H1N2)v.

Ky është rasti i dytë me virus variant të gripit gjatë sezonit 2025–2026 dhe rasti i parë në vitin kalendarik 2026.

Infeksionet njerëzore me viruset e gripit me origjinë nga derrat janë të rralla, por mund të ndodhin raste sporadike tek individët e ekspozuar ndaj kafshëve të infektuara.

Mpox nga grupimet I dhe II të virusit të lisë së majmunit – 2024–2026

Grupimi I dhe ai II i virusit të lisë së majmunit (MPXV) po qarkullojnë në disa vende. Ndërsa tendencat epidemiologjike të rasteve të Mpox mbeten përgjithësisht të ngjashme me javët e mëparshme, një numër rastesh të Mpox të grupimit I janë raportuar jashtë vendeve me transmetim komunitar dhe tek meshkujt që kryejnë marrëdhënie seksuale me meshkuj.

Që nga përditësimi i mëparshëm, nuk janë raportuar ndryshime të mëdha epidemiologjike për mpox të grupimit I ose grupimit II.

Në kontinentin afrikan, shumica e rasteve të Mpox të grupimiy I që nga viti 2024 janë raportuar nga Republika Demokratike e Kongos (RDK), Uganda dhe Burundi. Tendencat janë në ulje, megjithëse me luhatje javore.

Raste sporadike të Mpox të grupimit I janë raportuar edhe jashtë kontinentit afrikan, përfshirë persona pa histori udhëtimi në zona me qarkullim të grupimit I. Kjo tregon transmetim më të gjerë jashtë Afrikës dhe mundësisht brenda rrjeteve seksuale.

Klasifikimi i modeleve të transmetimit të mpox të grupimiy I u përditësua më 12 maj 2026.

Shpërthim i sëmundjes nga hantavirusi në një anije kroçere – Atlantiku Jugor – 2026

Deri më 13 maj janë raportuar gjithsej 11 raste, përfshirë:

8 raste të konfirmuara,

2 raste të mundshme,

1 rast të papërcaktuar.

Nuk janë raportuar raste të reja ose vdekje që nga përditësimi i mëparshëm.

Anija kroçere MV Hondius mbërriti në portin Granadilla, Tenerife, më 10 maj. Zbritja e pasagjerëve dhe një pjese të ekuipazhit përfundoi më 11 maj, ndërsa riatdhesimi i të gjithë pasagjerëve dhe anëtarëve të ekuipazhit në vendet e tyre u përfundua po atë ditë.

Anija u largua nga Tenerife më 11 maj dhe ishte planifikuar të mbërrinte në Holandë më 17 ose 18 maj.

Analiza paraprake e sekuencimit gjenomik tregoi ngjashmëri të lartë gjenetike midis izolateve të virusit Andes, duke sugjeruar një ngjarje fillestare zoonotike të transmetimit nga kafsha tek njeriu, e ndjekur nga transmetim nga njeriu tek njeriu.

Rreziku nga hantavirusi i lidhur me këtë shpërthim në anijen kroçere për popullatën e përgjithshme në Shqipëri dhe Europë konsiderohet shumë i ulët.